



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 48 prot

Durrës, më 8 / 11 .2017

V E N D I M

Nr. 31 , datë 20 / 11 2017.


P Ë R

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË STUDIMIT PËR STUDENTËT TË CILËT  
JANË REGJISTRUAR PËR HERË TË PARË NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE  
ME KOHË TË PLOTË PRANË UNIVERISTETIT "ALEKSANDËR MOISIU",  
DURRËS, NË VITIN AKADEMIK 2017-2018**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", pika 3, gërma ç "*autonomia financiare garantohej nëpërmjet së drejtës: për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj*", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Udhëzimit të MAS nr. 15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017 - 2018", i ndryshuar me udhëzimin nr. 18 datë 16.08.2017, Shkresës nr. 335/2/1 prot., datë 04.04.2017 me objekt "Kthim përgjigje, për kuotat dhe tarifat e propozuara për vitin akademik 2017-2018, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", Vendimit nr. 18 datë 01.12.2016 të Këshillit të Administrimit "Për miratimin e numrit, masës së kësteve të pagesës së tarifës së shkollimit, për studentët të cilët janë regjistruar për herë të parë në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë (master profesional ose shkencor) në vitin akademik 2016 - 2017, si dhe rastet (përjashtimore/ reduktim) nga tarifa e shkollimit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, në mbledhjen e datës 20.11.2017, Bordi i Administrimit i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Manaxhimit Financiar,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifave të studimit, për studentët të cilët janë regjistruar për herë të parë, në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë (Master i Shkencave/Master Profesional), në vitin akademik 2017-2018, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur.



2. Miratimin e numrit dhe masës së kësteve të pagesës së tarifës së shkollimit, për studentët të cilët janë regjistruar për herë të parë në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë (Master i Shkencave/Master Profesional), në vitin akademik 2017-2018, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur.

3. Tarifa totale e shkollimit, do të jetë sipas totalit të krediteve të fituara në programin e studimit.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:

- Kancelari
- Drejtorja e Manaxhimit Financiar
- Dekani i Fakultetit të Biznesit
- Dekani i Fakultetit të Edukimit
- Dekani i Fakultetit të Studimeve Profesionale
- Dekani i Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike
- Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**  
**Alqi KUSHI**



UNIVERSITÄT - RI

UNIVERSITÄT - RI

|                                                                     |        |
|---------------------------------------------------------------------|--------|
| Tarifa<br>totale e<br>shkollimit<br>sipas<br>totalit te<br>kreditve | 60,000 |
| te fituar                                                           | 90,000 |
| leke                                                                |        |

|         |
|---------|
| 72,000  |
| 108,000 |

|         |
|---------|
| 14,000  |
| 150,000 |

|         |
|---------|
| 172,800 |
| 180,000 |